



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## DREJTORIA E ARSIMIT

Nr. 05/295  
Podujevë,  
15 qershor 2022

Duke u bazuar në nenin 62 par 3, nenit 17 pika s të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, nenit 64.4, nenit 19 pika 1.19, të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18 dt 29.06.2018, nenit 15 dhe 16 të Rregullores për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së Subvencioneve nr. 01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, Drejtoria e Arsimit, shpall:

## K O N K U R S

### PËR NDARJEN E BURSIVE PËR STUDENTË TË KOMUNËS SË PODUJEVËS PËR VITIN AKADEMIK 2021 - 2022

#### Kriteret e përgjithshme

Përfitues të bursave mund të jenë:

- Vetëm studentët e rregullt – viti i dytë ( II ) e tutje të regjistruar në fakultetet e Universiteteve Publike të Republikës së Kosovës, duke përjashtuar studentët në studimet pasuniversitare – master dhe doktoraturë;
- Studentët duhet të mos jenë përsëritës të vitit akademik;
- Të jenë banor të komunës së Podujevës.

#### Kriteret e veçanta

1.Nota mesatare	
1.1 Nota mesatare, prej 9 deri 10.....	30 pikë
1.2 Nota mesatare, prej 8 deri 9.....	20 pikë
1.3 Nota mesatare, prej 7 deri 8.....	15 pikë
1.4 Nota mesatare, prej 6 deri 7.....	10 pikë
2. Numri i studentëve në familje (2 e më shumë).....	10 pikë
3. Kategoritë e dala nga lufta.....	10 pikë
4. Student në asistencë sociale.....	10 pikë
5. Student në fushat ku ka mungesë të kuadrove .....	10 pikë
5.1(Mjekësi e përgjithshme, matematikë, Inxhinieri elektrike, mekanikë dhe kompjuterikë, ndërtimtari dhe arkitekturë)	
6. Student me nevoja të veçanta.....	10 pikë
7. Student pa dy prindërit.....	20 pikë
8. Student pa njërin prind .....	10 pikë

**Vëmendje:** Kriteret e veçanta sipas pikës dy (2), vlerësohen vetëm për një student të asaj familje dhe vetëm nëse dëshmon me dokumentacion zyrtar se të gjithë studentët e asaj familjeje i plotësojnë kriteret e përgjithshme.

**Dokumentet e nevojshme për aplikim :**

- Aplikacioni sipas formës së komunës së Podujevës;
- Kopja e ID-së së studentit;
- Vërtetimin se studenti ka regjistruar vitin akademik 2021 -2022 (origjinale);
- Kopja e dokumentit të identifikimit;
- Certifikata e notave (origjinale);
- Certifikata e vendbanimit;
- Vërtetim se është anëtar i ngushtë i familjes së kategorive të dala nga lufta;
- Vërtetim për shfrytëzimin e ndihmës sociale të lëshuar nga Qendra për Punë Sociale në Podujevë (kjo vlenë për shfrytëzuesit të cilët aktualisht marrin ndihmë sociale);
- Për studentët pa njërin ose dy prindërit-certifikata e vdekjes;
- Për studentët me nevoja të veçanta- vendimi/vërtetimi zyrtar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

**Vërejtje:** Dokumentet e pakompletuara sipas kriterëve të lartcekura, dhe ato të dorëzuara pas afatit zyrtar nuk do të shqyrtohen.

**Vini re**

Dokumentet dorëzohen në Qendrën e shërbimit për qytetarë në objektin e Komunës – rr. “Nuhi Gashi”, në afat prej **15** ditësh nga dita e publikimit në tabelën e shpalljeve të objektit të Komunës, në mediat e shkruara dhe në web-faqen e Komunës <http://kk.rks-gov.net/podujeve> , gjegjësisht nga data: **15.06.2022** deri më **30.06.2022**.

*Lartësia e bursës do të caktohet varësisht nga buxheti i Drejtorisë për Arsim dhe nga numri i atyre që i plotësojnë kushtet për përfitimin e bursës.*

**Drejtoria e Arsimit**

